

VENDIM
Nr. 595, datë 10.9.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 938, DATË 17.11.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË KLUBIT
SPORTIV “DINAMO” NGA MINISTRIA E BRENDSHME TE MINISTRIA E
TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 250, DATË 24.4.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13,14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 938, datë 17.11.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”, zëvendësohet me “Ministria e Arsimit dhe Sportit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama